



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE ✓

VENDIM

Nr. 85, Datë 23.09.2020

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- Znj. Klotilda Neziri Kryetare
- Znj. Joniada Zaimaj Anëtare
- Anairda Arizaj Anëtare
- Blerta Çani (Drenofci) Anëtare

në mbledhjen e tij të datës 23.09.2020, vazhdoi shqyrtimin e çështjes “*Respektimin e të drejtës së konsumatorëve, për garantimin e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së produktit brenda afatit kohor prej 2 vjetësh, për produktet që tregtohen nga subjekti “Shpresa AL” kundrejt Shoqërisë tregtare “Shpresa AL”*”.

Komisioni pas shqyrtimit të çështjes së sipërpërmendur,

VËREN SE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve (KMK), në mbledhjen e datës 26.12.2019, ka filluar shqyrtimin administrativ mbi ankesën e paraqitur nga një konsumator, kundrejt subjektit “Shpresa AL” sh.p.k, administruar nga KMK me nr. 31 Prot., datë 19.12.2019. Ankesa konsistonte në pretendimin për mos respektim të të drejtave të konsumatorit dhe angazhimeve të vetë subjektit gjatë periudhës së garancisë së produktit, mbas blerjes së një produkti në një nga njësitë e subjektit tregtar.

KMK, mbas shqyrtimit të ankesës, në cilësinë e institucionit përgjegjës për mbrojtjen e interesave kolektive të konsumatorëve, bazuar në nenet 52 dhe 55 të Ligjit nr. 9902/2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe në pikën 9 të VKM nr. 1444, date 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e te pagesës se anëtarëve te komisionit te mbrojtjes

se konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”, ju drejtua subjektit “Shpresa AL” sh.p.k, me shkresën nr. 31/1 Prot. (KMK), datë 31.12.2019, duke vënë në dispozicion kopje të ankesës, dhe duke kërkuar dhënien e një informacioni sa më të plotë, lidhur me praktiken tregtare të ndjekur nga subjekti:

- në rastin e konsumatorit, në shitjen e produktit “Nokia 3.1 Blue” me garanci 12 mujore; si dhe
- në respektimin e të drejtës së konsumatorëve, për garantimin e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së produktit brenda afatit kohor prej 2 vjetësh, për produktet që tregtohen nga subjekti “Shpresa AL”.

Subjekti me anë të kësaj shkrese u vu në dijeni gjithashtu, se mosdhënia e informacionit të kërkuar, sipas kërkesave ligjore të nenit 52/1 të ligjit Nr. 9902/2008, i ndryshuar përbën shkelje administrative dhe dënohet në bazë të legjislacionit në fuqi. Subjektit ju la afati për dërgimin e përgjigjes pranë KMK datës 20 janar 2020.

Njëkohësisht KMK për zgjidhjen e ankesës individuale të konsumatores, mbështetur në nenin 51 të Ligjit Nr. 9902/2008, i ndryshuar, me shkresën nr. 31/2 Prot. (KMK), datë 31.12.2019, ja përcolli këtë ankesë për kompetencë Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT).

Në mbledhjen e datës 28.02.2019, KMK ka konstatuar mungesën e përgjigjes nga subjekti “Shpresa AL”. Komisioni është vënë në dijeni nga ISHMT, me shkresën nr. 55/6, datë 28.01.2020 dhe administruar nga KMK me nr. 31/3 Prot. (KMK), datë 4.02.2020, për zgjidhjen e ankesës së konsumatores nga ISHMT.

Në kushtet ku, ankesa e konsumatores rezultonte e zgjidhur, KMK vlerëson se praktika e ndjekur nga tregtari për sa i takon çështjes në mbrojtje të interesit të kolektiv/të përgjithshëm të konsumatorëve “Për respektimin e të drejtës së konsumatorëve, për garantimin e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së produktit brenda afatit kohor prej 2 vjetësh, për produktet që i tregtohen konsumatorëve”, *“prima facie”*, përbën praktikë çorientuese tregtare lidhur me të drejtat e konsumatorit (neni 14) dhe si e tillë ka vazhduar me shqyrtimin administrativ kundrejt subjektit.

Komisioni vendosi rikërkimin e informacionit nga ana e subjektit “Shpresa AL”, me anë të shkresës nr. 31/3-1 Prot. (KMK), datë 01.5.2020, duke i saktësuar se kërkohej informacioni plotë lidhur me:

“Respektimin e të drejtës së konsumatorëve, për garantimin e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së produktit brenda afatit kohor prej 2 vjetësh, për produktet që tregtohen nga subjekti “Shpresa AL”.

Komisioni në mbledhjen e radhës së datës 18.06.2020, vazhdoi me shqyrtimin administrativ të çështjes, ku mori në shqyrtim përgjigjen e subjektit “Shpresa AL” të datës 14.05.2020, administruar nga KMK me nr. 31/5 Prot., datë 27.05.2020. Komisioni konstatoi se, informacioni i dhënë nga ana e subjektit “Shpresa AL” nuk sqaronte aspak çështjen për të

cilën ishte kërkuar informacion, por jepte informacion vetëm për zgjidhjen e ankesës së konsumatorëve. Pra, informacioni i dhënë nuk ishte në përputhje me sa ishte kërkuar nga komisioni.

Në këto kushte, Komisioni në zbatim të neneve 52 dhe 55 të Ligjit nr. 9902, dt.17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar, si dhe pikës 9, të VKM nr. 1444, dt.22.10.2008, “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”, ju ridrejtuara me anë të shkresës nr. nr. 31/6 Prot. (KMK), datë 30.06.2020, me të njëjtën kërkesë, dhënien e një informacioni të plotë e sqarues mbi:

“respektimin e të drejtës së konsumatorëve, për garantimin e detyrimit ligjor të përputhshmërisë së produktit brenda afatit kohor prej 2 vjetësh (garancia ligjore), për produktet që tregtohen nga subjekti “Shpresa AL”” .

Subjektit ju la afati për dërgimin e përgjigjes pranë KMK brenda datës 14 korrik 2020, si dhe ju përsërit njoftimi se mosdhënia e informacionit të kërkuar, sipas kërkesave ligjore të nenit 52/1 të ligjit Nr. 9902/2008, i ndryshuar, përbën shkelje administrative dhe dënohet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Në mbledhjen e radhës së Komisionit, të datës 23.09.2020, u vazhdua me rishqyrtimin e çështjes në fjalë. Komisioni konstatoi se, megjithëse informacioni i është kërkuar në mënyrë të përsëritur dhe shkresa nuk është kthyer nga shërbimi postar, subjekti nuk ka paraqitur asnjë informacion me shkrim, apo ndonjë përgjigje zyrtare, me anë të së cilës për arsye objektive të kërkohej shtyrja e afatit apo të justifikohesh mosdhënia e informacionit.

Komisioni duke vlerësuar se çështja hyn në fushën e zbatimit të ligjit për mbrojtjen e konsumatorëve dhe shqyrtimi i çështjes është në kompetencë të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, për arsye se, çështja objekt shqyrtimi, konsiston në një marrëdhënie midis tregtarit dhe konsumatorëve, për sa kohë tregtari ofron një shërbim kundrejt pagesës drejtuar konsumatorëve, dhe rrjedhimisht brenda fushës së zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, të ndryshuar.

Për sa më sipër, mbështetur në nenin 52/1, të ligjit nr. 9902/2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar, sipas të cilit:

“Tregtarët janë të detyruar të japin, në mënyrë të qartë, të vërtetë dhe jo të mangët, të gjithë informacionin e kërkuar nga organet zbatuese dhe struktura përgjegjëse për mbrojtjen e konsumatorëve, sipas dispozitave të këtij ligji”,

konstatoi shkelje të këtij neni, si pasojë e mungesës së dhënies së informacionit të kërkuar nga Komisioni.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve mbështetur në nenin 52, pika 4, nenin 55, nenin 52/1 dhe nenin 57 pikën 2/(d) të Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatoreve”, i ndryshuar, si dhe në pikën 6 (c), të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008 “Për mënyrën e funksionimit e të pagesës së anëtarëve të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve, si dhe përcaktimin e procedurave të vlerësimit të shkeljeve”.

VENDOSI:

1. Subjekti “Shpresa AL” shpk, të gjobitet me shumën 300.000 lekë.
2. Subjekti “Shpresa AL” shpk, të njoftojë menjëherë Komisionin e Mbrojtjes së Konsumatorëve për pagesën e gjobës brenda 15 ditësh nga marrja e njoftimit të këtij Vendimi.
3. Publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve.

Kundër Vendimit të Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit keni të drejtë të ankoheni në Gjykatë brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni për vendimin.

